



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:079486

Datë: 13.03.2025

Numri i dokumentit: 06982075

Ac.nr.2781/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi – kryetar i kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr. “L.e.P”, Magj.Prishtinë-Fushë Kosovë, pn., të cilën sipas autorizimit nga Debt Loan Recovery Sh.P.K. me seli në Prishtinë, D.Y, kundër të paditurit N.(T).Rr nga fshati P....., Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit 1,742.00€, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan -Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.214/2019, i datës 27.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit N.(T).Rr nga fshati P....., Komuna e Gjilanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.214/2019, i datës 27.02.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.214/2019, i datës 27.02.2023 ka vendosur si në vijim: “

I.APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri N.(T).Rr nga fshati P....., Komuna e Gjilanit, që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 25.03.2016 në Gjilan, t’ia paguaj paditëses shumën prej 1,742.00, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.. ”

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur i padituri për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses apo të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195.1 pika d) lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, me datë 13.09.2019 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit N.(T).Rr nga fshati P..... Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar rimbursimin e dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vërtetimit të gjendjes faktike ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.214/2019, i datës 27.02.2023 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: “Nga transferi bankar i datës 29.12.2016, gjykata vërtetoi faktin se për Miranda Rexhën, është transferuar shuma prej 959.00€.

Nga ujdia jashtëgjyqësore, numër 874/16 e datës 21.12.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se BKS me të dëmtuarën M.R, janë dakorduar që për shkak të lëndimit të pësuar në aksidentin e datës 25.03.2016, t’i paguhet zhdëmtimi në shumën prej 744.00€, dhe shpenzimet e përfaqësimit të avokatit në shumën prej 215.00, e në shumë të përgjithshme prej 959.00€, në xhirrollogarinë 1702-0030-2617-1632 në Bankën NLB në emër të av. R.L.

Nga raporti i aksidentit me nr.2016-CR-100 i datës 25.03.2016, gjykata vërtetoi faktin se është dyshuar se deri te aksidenti ka ardhur kur Nj-A ishte duke lëvizur në aksin rrugor P.....-Gjilan dhe me të arritur te rruga e Shillovës së Muhaxherëve, gjatë përballkalimit me NJ-B, papritur i shkëputet-ndahet nga traktori rimorkio e motokultivatorit ku me këtë rast rimorkio kalon në shiritin e kundërt të majtë qarkullues dhe ndeshet në krahun e e parë të majtë me NJ-B e cila ishte duke lëvizur në drejtim të Kamenicës.

Nga urdhër transferi bankar i datës 13.05.2018, gjykata vërtetoi faktin se BKS përmes bankës ekonomike i ka transferuar në emër të M.R, për të dëmtuarin F.Kn në shumën prej 783.00€, përmes kostos së të autorizuarës M.R në xhirrollogarinë 1185-0036-5001-0108 në Bankën PCB.

Nga ujdia jashtë gjyqësore e datës 13.04.2016, me numër 380/16, gjykata ka vërtetuar faktin se

BKS me të dëmtuarin F.K, janë dakorduar që në emër të dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 25.03.2016, t'i paguhet zhdëmtimi në shumën prej 783.00€,

Nga vendimi i shkallës së parë për trajtimin e dëmeve, gjykata vërtetoi faktin se komisioni i shkallës së parë për trajtimin e dëmeve ka vlerësuar se për F.K n ekziston baza juridike për kompensimin e dëmit në automjetin e dëmtuar në shumë prej 783.00€.

Nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit e përpiluar nga A.M, inxh.i diplomuar i komunikacionit, me datë 15.07.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se është konstatuar që deri te aksidenti ka ardhë për shkak të lëshimeve të bëra nga automjeti i njësisë “A”, z.N.(T).Rr., i cili me automjetin bujqësor-Traktor tipit “IMT-539” me tabela 06-924-VA(i skaduar), me datën 25.03.2016 rreth orës 16:20, ka qarkulluar në rrugën Nacionale N25-3 me kahje Bujanovc-Gjilan, me të arrit te udhëkryqi i Shillovës së Muhaxherëve, si pasojë e lidhjes nyjore të gjysëmrimorkios joadekuate (gjysëmrimorkio e motokultivatorit në traktor Imt539), i shkëputet e gjysëmrimorkio nga traktori duke vazhduar lëvizjen e pakontrolluar në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe diku rreth 0.35m përtej vijës ndarëse apo Pg-ja 2.8m nga skaji i majtë rrugës godet njësinë “B” automjetin transportues VË Pick-up në anësoren e majtë ka dera e majtë. Me çrast është shkaktar i këtij aksidenti me lëndime trupore dhe dëme materiale.

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në nenin 136, paragrafi 1 dhe 2 përcakton se “Kush i shkaktonte dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji”; në nenin 137 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”; nenin 140 se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, nenin 154 se “Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”; nenin 155 se “Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”; nenin 159, paragrafi 1 se “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”; nenin 169, paragrafin 1 dhe 2 se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”; nenin 960, paragrafi 1 se “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”; në lidhje me dispozitat nga Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia që në nenin 18, paragrafi 1 dhe 4 ka përcaktuar se “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësia, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme

nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”, dhe pika 4 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësishë ka paraparë se “Byroja ka të drejtë regresive për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”, andaj në rastin konkret paditësja ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri, që paditësja e kishte kompenzuar të dëmtuarit dhe për këto arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësit është e bazuar në ligj dhe e mbështetur në prova, ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata ka gjetur se i padituri në këtë çështje kontestimore ka shkaktuar aksident trafiku, nga i cili aksident i është shkaktuar dëm të dëmtuarve F.K dhe M.R, se i padituri në rastin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pas mbulesë siguruese; se paditësja në emër të të paditurit i ka shpërblyer të dëmtuarit për dëmin e shkaktuar nga ky aksident; dhe se paditëses pas këtij shpërblimi i ka lindur e drejta e regresit për këtë shpërblim ndaj tani të paditurit.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurit se në shkaktimin e aksidentit, nga raporti i policisë mbi aksidentin shihet se i dëmtuari duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës për ta ndaluar para çdo pengese që i paraqitet në rrugë, ndeshet papritmas me rimorkion e shkëputur pa fajin e tij ekskluziv dhe shkaktohet aksidenti, mirëpo të njëjtin pretendim gjykata e vlerësoi të pambështetur në asnjë provë, ndërsa në procedurë civile është detyrë e palëve që të paraqesin faktet mbi të cilat mbështetin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova me të cilat konstatojnë faktet e tilla, ashtu që secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, pasi pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, ndërsa në qoftëse gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës, si në nenin 7, 319 dhe 322 të LPK-së. Meqë i padituri nuk ka dëshmuar pretendimin e tij, ndërsa paditësi ka vërtetuar pretendimet e tij duke i mbështetur me provat e theksuara si më lartë, konkretisht ekspertizës së komunikacionit, të cilës gjykata ia fali besimin në tërësi pasi e njëjta ishte e përpiluar në mënyrë profesionale dhe me të arriturat nga shkenca, andaj edhe vendosi sipas barrës së provës, ashtu që vlerësoi se nga raporti i aksidentit dhe ekspertiza e komunikacionit i del përgjegjësia të paditurit në mënyrë të qartë se i njëjti me veprimet e tij e ka shkaktuar aksidentin në fjalë.

Sa i përket lartësisë së kërkesës, gjykata e vlerësoi të bazuar të njëjtën, meqë u dëshmuua kjo lartësi në ujdite jashtëgjyqësore dhe transferet bankare të paditëses me të dëmtuarit, pasi sipas të drejtës së regresit, rimbursimi i takon vetëm në lartësinë e shpërblyer të dëmit.

Gjykata, sa i përket kamatës nuk ka vendosur pasi që pala paditëse nuk e ka specifikuar lartësinë e saj.

Nga të lartë cekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 e lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që asnjëra palë nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës.”

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Gjykata ankimore duke vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur vlerëson se nuk mund të qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin pasi një pretendim i tillë është tërësisht i pa qëndrueshëm e aq më pak i argumentueshëm se në cilën pikë apo pjesë dispozitivi qenka në kundërshtim me arsyetimin, pasi sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është në një vijë dhe rrjedhë logjike sikurse u cek më lartë, arsyetimi vetëm se e sforcon atë që është thënë dhe vendosur në dispozitiv pse një kërkesëpadi e tillë është e bazuar dhe pse detyrohet pala e paditur ta kompensojë paditësen për dëmin e shkaktuar me rastin e kompensimit të dëmit personave të tretë nga shkaktimit sipas përgjegjësisë së të paditurit dhe në mungesë të mbulesës siguroese.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me shkelje dispozitave nga neni 160 par.4 dhe 5 të LPK-së, pasi që sipas vlerësimit nga ana e Gjykatës së Apelit gjykata e shkallës së parë arsyetimin e aktgjykimit e ka në përputhje të plotë me kërkesat nga neni 160.4 të LPK-së, pra ka dhënë arsye për secilin fakt dhe mënyrë të të provuarit nga e cila ka rezultuar se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar, poashtu dejtë e ka zbatuar të drejtën materiale.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të palës paditëse se e njëjta është dorëzuar pas kalimit të afatit 7 ditor, sepse vula e pranimit në gjykatës është e vërtetë se është me datë 27.09.2022, mirëpo data e dorëzimit në postë është data 22.09.2022 pra brenda afatit, dhe se kur një parashtrësë dorëzohet përmes postës data e dorëzimit në postë është data kur duhet të konsiderohet se është dorëzuar me rregull në gjykatë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike pasi në raport me bazën juridike baza është vërtetuar me ekspertizë të komunikacionit

sipas së cilës fajtor në shkaktimin e aksidentit ka qenë i padituri e të njëjtin mendim bindshmë e mbrojtji në gjykatë, ndërsa kundërshtimi i të paditurës në raport m ekspertizën është kundërshtim i pa bazë, sepse të paditurit por edhe gjykatës i mungon njohuria profesionale nga fusha e caktuar, ndërsa mendimi i ekspertit ka qenë i plotë profesional dhe objekti është bazuar në raport të policisë, propozimi për me dal në vend gjykata ka qenë i paargumentuar sepse në raste të tilla nëse e sheh të nevojshme del eksperti kur nuk ka material të mjaftueshëm por jo gjykata, pastaj lartësia e kompensimit është në përputhje të plotë me dëmin e kompensuar nga paditësja personave të tretë e që kjo vëretohet nga ujdite jashtëgjyqësore dhe urdhër transferet.

Baza juridike apo e drejta materiale që ia garanton të drejtën e rimbursimit të dëmit palës paditëse nga i padituri përcaktohet me nenin 14.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia : *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”*

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur për lartësi të kamatës, pasi kamata është gjykuar konform dispozitës së nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është i drejtë dhe në përputhje më dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur menenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2781/2023 , datë 10.03.2025

Kryetar i Kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v.